



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë, më, 31.10.2011

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR

**DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, NR. 7122, DATË 14.10.2011
“PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR. 10 463, DATË 22.09.2011,
“PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE””.**

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenin 86, pika 2 e Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 31 tetor 2011, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës, nr.7122, datë 14.10.2011 “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve””.

Në motivimin e tij Presidenti i Republikës ka paraqitur tre çështje për të cilat, ai arsyeton kthimin për rishqyrtim:

1. Arsyeya e e kthimit të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është se: neni 49, i cili parashikon importin e mbetjeve jo të rrezikshme, vjen në kundërshtim me nenin 1 të ligjit, i cili parashikon qëllimin e tij; sipas nenit 2 pika 1 e këtij ligji, dispozitat zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe neni 49 vjen në kundërshtim me objektin e ligjit; neni 49 vjen në kundërshtim me objektin e ligjit, neni 2, pika 2 të tij.

Në mbledhjen e Komisionit, të ftuar, për të shpjeguar qëndrimin e tyre në lidhje me dekretin e Presidentit të Republikës dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin zv/ministri i Mjedisit, Pyejeve dhe Administrimit të Ujrave z. Bino, si dhe përfaqësues të kësaj Ministrie.

Nisur nga shqetësimi i ngritur në opinionin publik për çështjen e importit të mbetjeve, Komisioni pranoi kërkesën e grupeve të interesit për t’u dëgjuar gjatë shqyrtimit të dekretit të presidentit “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë të ligjit nr. 10 463, datë 22. 09. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Kështu për të shprehur opinionin e tyre në lidhje me këtë çështje ishin përfaqësues të Shoqatës për Politika të Reja për Mjedisin dhe të Aleancës Kundër Importit të Plehrave (AKIP). Gjithashtu të pranishëm ishin edhe vëzhgues të delegacionit të BE-së në Shqipëri.

Përfaqësuesit e AKIP u shprehën pro miratimit të ligjit, por kundër neneve që kanë të bëjnë me importin e mbetjeve. Sipas tyre, këto nene vijnë në kundërshtim me dispozitat e neneve që flasin për mbrojtjen e shëndetit dhe për reduktimin e mbetjeve. Ata theksuan se, vendi ynë nuk ka infrastrukturën e duhur administrative, monitoruese dhe ligjore, dhe se duhet të krijohet mundësia që, me ligj, t'i jepet përparësi vetëm mbetjeve të krijuara në vend. Gjithashtu shprehën dyshime për përputhshmërinë e kësaj çështjeje me direktivën kuadër të BE-së "Për menaxhimin e mbetjeve" si dhe me parimin e vetëmjaftueshmërisë dhe të afërsisë.

Përfaqësuesit e Shoqatës për Politika të Reja për Mjedisin u shprehën kundër përdorimit të termit "plehra" pasi është një term ç'edukues për shoqërinë. Gjithashtu u shprehën kundër importit të mbetjeve për depozitim apo ruajtje, që sipas tyre është e njëjta gjë, por pro importit të mbetjeve si lëndë të para dytësore për industrinë e riciklimit.

Zv/Ministri i Mjedisit theksoi përputhshmërinë e ligjit me direktivat europiane. Ai theksoi se ligji flet për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, dhe jo për ato që gjenerohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk përcakton burimet e krijimit të mbetjeve. Duke iu përgjigjur shqetësimit të sjellë nga shoqatat e mjedisit, theksoi që ligji ndjek frymën e vetëmjaftueshmërisë dhe të afërsisë si në nenin 22 ashtu edhe në nenin 49, pra nuk importohet për ruajtje kështu që bie shqetësimi për depozitim të mbetjeve. Kjo do të thotë se në territorin shqiptar nuk importohen mbetje nga vendet e tjera për t'i ruajtur diku apo për t'i asgjësuar, por për riciklimin e tyre, dhe kjo është plotësisht e përputhshme me kuadrin ligjor të mëparshëm. E konkretisht në ligjin nr. nr. 9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin e mbetjeve të ngurta" I ndryshuar, i cili shfuqizohet me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, importi për mbetjet jo të rrezikshme është i lejuar. Kështu vendimi i Këshillit të Ministrave nr.825, datë 13.10.2010 ka miratuar listën e gjelbër të mbetjeve jo të rrezikshme të cilat mund të importohen në Republikën e Shqipërisë, duke disiplinuar kështu importin e mbetjeve në vend. Kjo listë mbështetet në listën e gjelbër të Konventës së Bazelit dhe të BE-së dhe përbëhet nga rreth 55 lloje mbetjesh që është një numër shumë më i vogël se sa ai që lejon kjo Konventë, ku Shqipëria është palë. Importi bëhet sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr.806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave e procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi e riciklimi". Por, në të gjitha rastet, dhënia e një lejeje importi bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Për këto arsye përse i përket importit të mbetjeve për qëllime riciklimi e përpunimi ligji i kthyer nga presidenti nuk sjell risi në raport me legjislacionin ekzistues.

Në mungesë të importit asnjë industri riciklimi nuk do të ishte konkurruese në treg dhe asnjë nuk do të investonte në industri të tilla duke sjellë kështu edhe pamundësinë e riciklimit të mbetjeve të gjeneruara në vend.

Ligji respekton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe atë të mbrojtjes së mjedisit, është plotësisht i përputhur, dhe garanton mbrojtjen më të lartë, sepse në të nuk bëhet rregullim ligjor për mbetje të përziera, por për mbetje të ndara, që shërbejnë si mbetje-lëndë e parë.

Heqja e pretenduar e nenit 49 kompromenton menaxhimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, sepse rrezon të gjitha përpjekjet e biznesit vendas për të zhvilluar kapacitetet ricikluese në vend.

Institucionet e shtetit shqiptar i kanë kapacitetet e nevojshme monitoruese dhe ekspertizën laboratorike, për të kontrolluar mbetjet që do futen në territorin e Shqipërisë si lëndë e parë për industrinë ricikluese.

Deputetët diskutuan në lidhje me çështjen e importit të mbetjeve në vend duke paraqitur argumenta pro dhe kundër importimit të tyre në Republikën e Shqipërisë.

Deputetët e mazhorancës u shprehën se ligji parashikon importimin e atyre mbetjeve, të cilat janë përcaktuar në direktivat europiane dhe janë pjesë e riciklimit. Ai nuk lejon as importimin e mbetjeve të rrezikshme, dhe as depozitim ose ruajtjen e mbetjeve jo të rrezikshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, por lejohet sjellja e atyre mbetjeve që do të shërbejnë në mënyrë të përcaktuar, si lëndë e parë për industrinë ricikluese. Ata theksuan se në rast të kundërt, shkelet totalisht parimi i vetëmjaftueshmërisë, sepse nuk ka kuptim që të lejohet importi për një mbetje e cila nuk mund të përpunohet. Në territorin e Republikës së Shqipërisë do të importohen vetëm mbetjet e riciklueshme, pra që janë lëndë e parë për industrinë. Në ligj nuk bëhet fjalë për çdo lloj mbetjeje, por për një pjesë të tyre. Sensi dhe logjika e ligjit është për të importuar vetëm atë pjesë të mbetjeve që do t'i jepte kuptim ekonomik një investimi tashmë të kryer. Në rast se nuk lejohet riciklimi i mbetjeve, atëherë do të thotë që të gjitha industritë duhet të bëjnë shfrytëzim ekstensiv të burimeve natyrore të lëndëve të para, duke çuar në shterimin e plotë dhe më të shpejtë të burimeve ekonomike. Kjo shkel parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë njerëzore, shkel parimin që brezave të ardhshëm ne u lëmë një trashëgimi më pak, ose mundësi më të kufizuara për të ndërtuar progresin e tyre.

Deputetët e opozitës u shprehën se këto lëndë të cilat do të importohen në Shqipëri kanë impakt mjedisor, do të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujit, tokës e të ajrit si dhe do të krijojnë pasoja në natyrë e në burimet natyrore shqiptare. Ata u shprehën për ndalimin e importit si mënyrë për të mos dekurajuar nxitjen e menaxhimit të mbetjeve në vend, si dhe mbështetjen idenë e një moratoriumi përse i përket importit të mbetjeve duke theksuar se investitorët e këtyre industrive duhet që për 10 vjet të pezullojnë veprimtarinë e tyre, të merren vetëm me mbetjet e vendit, derisa shteti shqiptar të ketë mundësi të rrisë kapacitetet kontrolluese e monitoruese për këto lëndë.

Opozita është e mendimit se ligji nuk është i përshtatshëm, dhe ajo nuk ka rezerva vetëm për nenin 49 të tij, por për ligjin në tërësi. Gjithashtu përse i përket çështjes së importit, opozita hodhi idenë e një referendumi.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm, në zbatim të nenit 85, pika 2 të Kushtetutës vendosi t'i rekomandojë seancës plenare rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 7122, datë 14.10.2011 "Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"". Deputetët e opozitës votuan pro dekretit.

RELATOR

Osman METALLA

KRYETAR

Jemin GJANA